



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1132 Prot.

Tiranë, më datë 16.09.2022

VENDIM

Nr. 467, datë 16.09.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.09.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “KUZ Himarë dhe Himarë Fshat, ITUN Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë dhe ITUN Orikum”, me aplikues Genti Çupi dhe zhvillues Bashkia Himarë, Miratuar në Parim me Vendim KKTKM nr. 452, datë 31.08.2022;
 2. Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas aplikuesi mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Punimet në Qendrën Historike të Himarës, pranë Shpellës së Spillesë, si dhe pranë depos aktuale të ITUN Himarë, duhet të shoqërohen me një program monitorimi arkeologjik dhe dokumentimi stratigrafik nga subjekt i licencuar në arkeologji. Raportet e monitorimit arkeologjik dhe dokumentimit të depozitohen pranë IKTK;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145- 147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

